

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

**Raporti i audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare në datën dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	4
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit	3
Pasqyra e flukseve të parasë	4
1. Të përgjithshme	5
2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara	6
2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese	6
2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuar	7
3. Politika të rëndësishme kontabël	13
4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve	22
5. Paraja dhe ekuivalentët e saj	23
6. Shumat e kushtëzuara me Bankën Qëndrore	23
7. Hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare	24
8. Investime të vlefshme për shitje	24
9. Hua dhe paradhënie për klientët	26
10. Aktivitet e trupëzuara	29
11. Aktivitet e patrupëzuara	30
12. Aktivitet e mbajtura për shitje	30
13. Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore	30
14. Aktivitet e tjera	31
15. Detyrime ndaj institucioneve financiare	31
16. Detyrime ndaj klientëve	33
17. Detyrime të tjera	35
18. Detyrime tatimore të shtyra, neto	35
19. Kapitali i paguar	35
20. Analiza e aktiveve dhe detyrimeve dhe kapitalit sipas maturitetit	36
21. Të ardhura nga interesi	37
22. Shpenzime për interesa	37
23. Të ardhura nga komisionet	37
24. Shpenzime për komisionet	37
25. Zhvleresime dhe fshirje llogarish të tjera	37
26. Shpenzime personeli	38
27. Shpenzime të përgjithshme administrative	38
28. Tatimi mbi fitimin	38
29. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	39
30. Transaksionet me palët e lidhura	40
31. Ngjarjet pas datës së raportimit	41
32. Adminstrimi i rrezikut financiar	42

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Këshillin Drejtues të Banka Societe Generale Albania sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Societe Generale Albania sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017, si dhe të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri (Kodi IEKA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të vitit 2017 të Banka Societe Generale Albania sh.a

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2017, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2017 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka Societe Generale Albania sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

26 mars 2018
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.*(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e pozicionit financiar
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	3,774,418	7,104,355
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	6	6,349,420	5,986,772
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7	1,368,578	1,313,232
Aktive të mbajtura për shitje	12	87,424	104,314
Aktive të tjera	14	235,672	319,258
Investime të vlefshme për shitje	8	20,128,090	19,622,279
Hua dhe paradhënie për klientët	9.1	47,519,086	44,761,531
Qiratë financiare	9.2	1,029,878	688,226
Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore	13	349,439	582,170
Aktive të trupëzuara	10	344,979	498,838
Aktive të patrupëzuara	11	232,119	240,945
Totali i aktiveve		<u>81,419,103</u>	<u>81,221,920</u>
Detyrimet			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	15	3,623,800	7,629,534
Detyrime ndaj klientëve	16	68,196,427	64,199,730
Detyrime që lidhen me aktivet e mbajtura për shitje	12	26,458	25,221
Detyrime të tjera	17	525,204	412,596
Detyrime tatimore të shtyrë, neto	18	71,092	75,392
Totali i detyrimeve		<u>72,442,981</u>	<u>72,342,473</u>
Kapitali			
Kapitali aksionar	19	6,740,900	6,740,900
Primi i aksioneve		1,750	1,750
Rezerva ligjore		596,180	95,614
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	8	462,565	492,795
Fitimi i paspërndarë		1,174,727	1,548,388
Totali i kapitalit		<u>8,976,122</u>	<u>8,879,447</u>
Totali detyrimeve dhe kapitalit		<u>81,419,103</u>	<u>81,221,920</u>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 66, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.*(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	21	3,262,476	3,399,634
Shpenzime për interesat	22	(352,016)	(557,592)
Të ardhura neto nga interesat		2,910,460	2,842,042
Të ardhura nga komisionet dhe tarifatat	23	552,821	486,649
Shpenzime për komisionet dhe tarifatat	24	(96,636)	(78,952)
Të ardhura neto nga komisionet dhe tarifatat		456,185	407,697
Fitimi nga kurset e këmbimit		131,476	85,544
Humbja nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(82,158)	(5,314)
Humbje të tjera, neto		(2,702)	(4,134)
Humbje nga shitja e aktiveve të mara në rrugë ligjore		(107,924)	(66,330)
		(61,308)	9,767
Zhvlerësime dhe fshirje llogarish të tjera	25	(1,058,395)	(1,068,912)
Zhvlerësimi i aktiveve të trupëzuara	10	(71,666)	(84,199)
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	11	(59,277)	(54,014)
Shpenzime personeli	26	(745,248)	(702,377)
Shpenzime të përgjithshme administrative	27	(892,425)	(894,835)
		(2,827,012)	(2,804,337)
Fitimi para tatimit		478,325	455,169
Shpenzime tatim fitimi	28	(79,719)	(87,256)
Tatim fitimi i shtyrë	18	4,299	(65,783)
Fitimi i vitit, neto		402,905	302,130
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse			
<i>Të ardhura të tjera përmbledhëse për tu riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat e ardhshme:</i>			
· Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(30,230)	389,090
		(30,230)	389,090
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin, pas tatim fitimit		(30,230)	389,090
Totali i fitimit dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin, pas tatim fitimit		372,675	691,221

Pasqyra fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 66, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.*(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e ndryshimit të kapitalit
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i paguar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore	Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	6,740,900	1,750	4,618	103,705	1,628,714	8,479,687
Fitimi i vitit	-	-	-	-	302,130	302,130
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	389,090	-	389,090
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	389,090	302,130	691,221
Kapitali i nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividentë të paguar	-	-	-	-	(291,460)	(291,460)
Rezerva ligjore dhe të tjera	-	-	90,996	-	(90,996)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	6,740,900	1,750	95,614	492,795	1,548,389	8,879,448
Fitimi i vitit	-	-	-	-	402,905	402,905
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	(30,230)	-	(30,230)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	(30,230)	402,905	372,675
Kapitali i nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividentë të paguar	-	-	-	-	(276,000)	(276,000)
Rezerva ligjore dhe të tjera	-	-	500,566	-	(500,566)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,740,900	1,750	596,180	462,565	1,174,727	8,976,122

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 66, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.*(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)***Pasqyra e flukseve të parasë
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga operacionet:		
Fitimi para tatimit	478,325	455,169
<i>Rregullime për të kuadruar rezultatin neto me rrjedhjen neto të aktiveve monetare nga veprimtaritë operative:</i>		
Zhvierësimi i aktiveve të trupëzuara	10 71,667	84,199
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	11 59,277	54,014
Zhvierësimet dhe fshirje llogarish të tjera	25 1,026,149	929,504
Zhvierësimet mbi aktivet e mara në rrugë ligjore	32,246	134,584
Humbja nga shitja e aktiveve të trupëzuara	82,158	5,314
Humbje nga shitja e aktiveve të mara në rrugë ligjore	107,924	66,330
Të ardhura nga interesat	21 (3,262,476)	(3,399,634)
Efektet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	73,426	36,769
Shpenzime për interesat	22 352,016	557,592
Flukset e parasë nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative	(979,288)	(1,076,159)
<i>Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:</i>		
Rritje në shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	(362,660)	(381,193)
Rritje në huatë dhënë institucioneve financiare	(55,346)	(19,664)
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët	(3,120,074)	(5,217,816)
Pakësim në aktive të tjera	203,890	244,731
Pakësim/(rritje) në detyrimet ndaj institucioneve financiare	(4,002,906)	2,656,212
Rritje në detyrimet ndaj klientëve	3,039,329	4,545,369
Rritje në detyrime të tjera	112,607	126,629
Rritje në detyrime për me aktive të mbajtura për shitje	1,236	25,221
Interesi i arkëtuar	3,305,493	3,432,062
Interesi i paguar	(423,624)	(366,666)
Tatim fitimi i paguar	(90,573)	(153,039)
Flukset e parasë (përdorur)/nga në aktivitetet operative	(2,371,916)	3,815,687
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e letrave me vlerë neto me shitjet	(5,301,774)	(4,047,566)
Maturimi i letrave me vlere	4,670,170	4,705,744
Blerje e aktiveve të trupëzuara	(50,450)	(11,561)
Blerje e aktiveve të trupëzuara	(36,893)	(85,438)
Të hyra nga aktivet e trupëzuara	36,927	13,254
Flukset e parasë (përdorur)/nga në veprimtaritë investuese	(682,020)	574,433
Flukset e parasë nga veprimtaritë financiare:		
Pagesa e dividendit	(276,000)	(291,460)
Flukset e parasë përdorur nga veprimtaritë financiare	(276,000)	(291,460)
Rritja e parasë dhe ekuivalentët e saj	(3,329,937)	4,098,660
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7,104,355	3,005,695
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	5 3,774,418	7,104,355

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 66, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare të veçanta u miratuan nga Këshilli Drejtues i Bankës më 26 mars 2018 dhe janë firmosur nga:


Frederic Blanc
Drejtor i Përgjithshëm


Albana Hallvaxhiu
Drejtor i Financës

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)

1. Të përgjithshme

Banka Societe Generale Sh.a (“Banka”) është një institucion financiar i themeluar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare dhe u liçencua nga Banka e Shqipërisë (“Banka Qëndrore”) më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 “Mbi sistemin bankar në Shqipëri”, i muajit korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269, i dhjetorit 1997, “Mbi Bankën e Shqipërisë”. Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. Bazuar në marrëveshjen e blerjes së aksioneve të datës 18 prill 2007, Societe Generale bleu 75.01% të aksioneve të Bankës dhe rriti përqindjen e saj në 88.89% deri në fund të 2017.

Më 21 gusht 2009 Banka krijoi filialin e saj “Sogelease Albania sh.a” të cilin e zotëronte plotësisht. Më 31 Mars 2015 Banka dhe Sogelease Albania u bashkuan në një institucion të vetëm me emrin Banka Societe Generale Albania.

Më 31 dhjetor 2017, Banka ka operuar përmes zyrave qëndrore që ndodhen në Tiranë dhe 38 degëve të saj (2016: 37 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2017 Banka kishte 413 punonjës (31 dhjetor 2016: 410 punonjës).

Më 31 dhjetor 2017, Këshilli Mbikqyrës dhe Komiteti i Kontrollit të Bankës përbëhet nga antarët e mëposhtëm:

Këshilli Mbikqyrës	Jitka Pantuckova	Kryetare
	Daniela Hristova	Zv. Kryetare
	Adrian Civici	Anëtar
	Marie Le Picard	Anëtare
	Aleksandër Xhuvani	Anëtar
Komiteti i Kontrollit	Jitka Pantuckova	Kryetare
	Nataša Mohorčić-Zobec	Anëtare
	Diana Ylli	Anëtare

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara

2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese

SNK 7 Iniciativa për dhënie informacionesh shpjeguese - Ndryshime në SNK 7

Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare është pjesë e Inicativës së Publikimit të BSNK-së dhe ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një entiteti. Ndryshimet kërkojnë që entitet të japin informacion shpjegues rreth publikimeve në detyrimet e tyre që rrjedhin nga aktivitetet e financimit, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo-monetare (siç janë fitimet ose humbjet në valutë të huaj). Në aplikimin fillestar të amendamenteve, entiteteve nuk u kërkohet të japin informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Lejohet aplikimi i hershëm. Amendamentet synojnë të japin informacion për të ndihmuar investitorët të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një entiteti. Banka ka paraqitur informacion përkatës shtesë për periudhën aktuale në shënimin 19 të këtyre pasqyrave financiare.

SNK 12 Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara - Ndryshimet në SNK 12

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. BSNK ka lëshuar amendimet në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat për të sqaruar kontabilizimin për aktivet tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara mbi instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë. Amendamentet sqarojnë se një entitet duhet të marrë në konsideratë nëse ligji tatimor kufizon burimet e fitimeve të tatueshme, ndaj të cilave mund të bëjë zbritje për kthimin e kësaj diference të përkohshme të zbritshme. Për më tepër, ndryshimet sigurojnë udhëzime se si një entitet, duhet të përcaktojë fitimet e tatueshme në të ardhmen dhe të shpjegojë rrethanat në të cilat fitimi i tatueshëm mund të përfshijë rikuperimin e disa pasurive për më shumë sesa vlera e tyre kontabël. Entitetve u kërkohet të aplikojnë ndryshimet në mënyrë retrospektive. Megjithatë, në aplikimin fillestar të ndryshimeve, ndryshimi në kapitalin fillestar të periudhës krahasuese më të hershme mund të njihet në fitimet e pashpërndara të hapura (ose në një tjetër komponent të kapitalit, sipas rastit), pa akorduar ndryshimin midis fitimit të pashpërndarë të hapur dhe komponentëve të tjerë të kapitalit. Entitetet që aplikojnë këtë lehtësim duhet ta publikojnë këtë fakt. Lejohet aplikimi i hershëm. Nëse një entitet zbaton amendimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet t'i publikojë ato. Ndryshimet synojnë të heqin divergjencën ekzistuese në praktikë në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara. Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Bankën.

Përmirësimet vjetore për ciklin 2014-2016 (lëshuar në dhjetor 2016)

Këto përmirësime përfshijnë:

SNRF 1 Përshtatja e parë e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Zhdukja e përjashtimeve afatshkurtra për përshtatesit e parë

Përjashtimet afatshkurtra në paragrafët E3-E7 të SNRF 1 u fshinë sepse ata tani kanë kryer qëllimin e synuar. Amendimi hyn në fuqi që nga 1 janari 2018. Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Bankën.

SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta - Sqarimi që matja e të investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje për investim pas investimi

Amendamentet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe të jenë në fuqi nga 1 janari 2018, me leje të lejuara më herët. Nëse një entitet zbaton këto amendime për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta publikojë atë fakt. Këto ndryshime nuk janë të zbatueshme për Bankën.

SNRF 12 Publikimi i interesave në entitete të tjera

Ndryshimet hyjnë në fuqi nga 1 janari 2017 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Amendimi nuk zbatohet për Bankën.

Përmirësimet vjetore për ciklin 2015-2017 (lëshuar në dhjetor 2017)

Këto përmirësime përfshijnë:

SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - për periudhat raportuese vjetore që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi më i hershëm lejohet. Amendimi nuk zbatohet për Bankën.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

Përmirësimet vjetore për ciklin 2015-2017 (lëshuar në dhjetor 2017)

SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta - për periudhat raportuese vjetore që fillon më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi më i hershëm lejohet. Amendimi nuk zbatohet për Bankën.

SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat - për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Lejohet aplikimi më i hershëm. Amendimi nuk zbatohet për Bankën.

SNK 23 Kostot e Huamarrjes - për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Lejohet aplikimi më i hershëm. Amendimi nuk zbatohet për Bankën.

Miratimi i ndryshimeve të mësipërme në standarde nuk ka efekt në këto pasqyra financiare.

2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara

Standardet e publikuara, por që nuk janë akoma në fuqi dhe as nuk janë aplikuar hershëm nga Banka janë listuar më poshtë. Ky listim përmban standarde dhe interpretime të publikuara, për të cilat Banka pret të kenë ndikim në shënimet shpejguese, pasqyrën e pozicionit financiar, performancë kur të aplikohen në një datë të ardhshme. Banka ka qëllim t'i aplikojë standardet kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe ndryshimet që nuk janë të aplikueshme në Banka nuk janë të diskutuara në detaje.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Nxitjet e Qirasë Operative dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përjashtime njohjeje për qiramarrësit - dhënien me qira të aktiveve "me vlerë të vogël" (p.sh., kompjuterët personal) dhe qiratë afatshkurtra (dmth.qira me një afat kohor prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qirasë (dmth. Detyrimin e qirasë) dhe një aktiv që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivitetit bazë gjatë afatit të qirasë (p.sh. aktivin e të drejtës së përdorimit). Qiramarrësit do t'i kërkohej të njoh veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit në aktivin e të drejtës së përdorimit.

Qiramarrësit gjithashtu do t'i kërkohej që të rillogarisë detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rivlerësimit të detyrimit të qirasë si një rregullim në aktivin e së drejtës së përdorimit.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17.

SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo para se një entitet të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje të plotë retrospektive ose një modifikim retrospektiv. Dispozitat e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësime të caktuara. Banka po vlerëson ndikimin e mundshëm të SNRF 16 në pasqyrat financiare të saj.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë

Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), publikoi vesionin final të SNRF 9 Instrumentat Financiare, i cili zëvendësoi SNK 39 Instrumentat Financiare për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2018, ku informacioni krahasues nuk është i detyrueshëm. Në vitin 2017 Banka krijoi një projekt zbatimi me anëtarë nga Departamenti i Riskut, Departamenti i Financës, I.T. dhe DPO për të përgatitur implementimin e SNRF 9. Ky projekt u sponsorizua nga Drejtori i Riskut dhe Drejtori i Finances dhe menaxhohet brenda kornizës së transformimit të Bankës. Projekti vendosi një fluks individual për klasifikim dhe matje dhe zhvlerësim të cilat konkluduan fazat e mëposhtme: vlerësimi fillestar dhe analiza, studimi, testimi i sistemit, aplikimi paralelisht gjatë 2017 dhe dalja “live” në vitin 2018. Ekippet e Financës dhe të Riskut kanë vlerësuar kërkesat përkatëse për dhënien e informacionit shpjeguese.

(a) Klasifikimi dhe Matja

Pas përfundimit të vlerësimit paraprak, Banka arriti në përfundimin se:

- § Të gjitha huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët, të klasifikuara si kredi dhe llogari të arkëtueshme sipas SNK 39, pritet të maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9;
- § Portofoli i kredisë i SGAL përbëhet kryesisht nga kredi të dhëna klientëve me pakicë, korporatave dhe bankave, me një model biznesi të gjeneruar si «Mbajtur për t'u mbledhur».
- § Të gjitha letrat me vlerë të borxhit të klasifikuara si të mbajtura për shitje sipas SNK 39 pritet të maten me FVOCI (Vlerën e Drejtë nga të Ardhura të Tjera Gjithëpërfshirëse). Portofoli i letrave me vlerë të SGAL përbëhet nga bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare dhe obligacionet qeveritare, me një model biznesi të gjeneruar si «Mbajtur për t'u mbledhur dhe shitur».

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 gjithashtu do të ndryshojë rrënjësisht metodologjinë e zhvlerësimit të humbjeve të kredisë. Standardi do të zëvendësojë metodën e humbjeve të ndodhura të SNK 39 me një metodë humbjeje të pritshme (ECL). Bankës do t'i kërkohet të regjistrojë një provigjon për humbjet e pritshme për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në FVPL (Vlerën e Drejtë nga të Ardhurat dhe Shpenzimet), së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Provigjoni bazohet në humbjet e pritura të kredisë të lidhura me probabilitetin e mospagimit në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm përveçse nëse nuk ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, provigjoni bazohet në probabilitetin e mospagimit përgjatë gjithë jetës së aktivit.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim në fund të çdo tremujori nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e mospagimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

- Për të llogaritur humbjen e pritshme të kredisë “ECL”-në, Banka do të vlerësojë rrezikun e një përkeqësimi të instrumentit financiar përgjatë jetës së tij të pritshme. ECL-të janë vlerësuar bazuar në vlerën aktuale të të gjitha humbjeve në njete monetare përgjatë jetës së mbetur të pritshme të aktivitetit financiar, p.sh. diferenca ndërmjet: flukseve kontraktuale të mjeteve monetare që i detyrohen Bankës sipas kontratës dhe
 - Flukset monetare që Banka pret të marrë, të zhvlerësuar me normën efektive të interesit të huasë.
- Në krahasim me SNK 39, Banka pret që shitesa e provigjionit sipas SNRF 9 të jetë më e paqëndrueshëm se sa nën SNK 39 dhe të rezultojë në një rritje në nivelin total të zhvlerësimeve aktuale.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Banka i grupon kreditë e veta në Klasën 1, Klasën 2 dhe Klasën 3, bazuar në metodologjinë e zbatuar të zhvlerësimit, siç përshkruhet më poshtë:

- Klasa 1 – Kredi standart: kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njih një provigjon bazuar në humbjet e pritshme 12-mujore të kredisë.
- Klasa 2 – Kreditë me nënstandart: kur një hua tregon një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, Banka regjistron një provigjon për humbjen e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës.
- Klasa 3 – Kreditë e zhvlerësuara: Banka njih humbjet e pritshme të kreditimit përgjatë gjithë jetës për këto kredi. Përveç kësaj, në Klasën 3 Banka përllogarit të ardhura nga interesi për koston e amortizuar të huasë neto nga provigjoni.

Banka do të regjistrojë provigjone për letrat me vlerë të borxhit FVOCI, në varësi të faktit nëse ato klasifikohen në Klasën 1, 2 ose 3, si shpjeguar më sipër. Megjithatë, humbjet e pritshme të kredisë nuk do të zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, i cili do të mbetet me vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, një shumë e barabartë me provigjonin që do të lindte nëse aktivi do të matej me koston e amortizuar do të njihet në OCI (të Ardhura të Tjera Gjithpërfshirëse) si një shumë e akumuluar e zhvlerësimit, me një ngarkesë korresponduese në fitim ose humbje.

Për letrat me vlerë të borxhit "FVOCI" me rrezik të ulët, Banka synon të zbatojë një politikë që supozon se rreziku i kredisë në instrument nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe do të llogarisë ECL siç shpjegohet në Klasën 1 më poshtë. Këto instrumente do të përfshijnë në përgjithësi letrat me vlerë të investimit, të tregtuara, ku huamarrësi ka një kapacitet të fuqishëm për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale të flukseve të parasë në afat-shkurtër dhe ndryshimet e pafavorshme në kushtet ekonomike dhe tregtare në afat-gjatë, të cilat mund të reduktojnë, por jo domosdoshmërisht, aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet kontraktuale të flukseve të parasë.

Banka nuk do t'i konsiderojë instrumente si me rrezik të ulët të kredisë thjesht për shkak të vlerës së kolateralit.

Instrumentet financiare gjithashtu nuk konsiderohen të kenë rrezik të ulët të kredisë thjesht për shkak se ato kanë një rrezik më të ulët të dështimit krahasuar me instrumentet e tjera financiare të Bankës.

Klasa 1

Sipas SNK 39, Banka ka regjistruar një provigjon për humbjet nga zhvlerësimi Të Ndodhura por jo Të Identifikuar (IBNI-Incurred But Not Identified). Këto janë të projektuar për të pasqyruar humbjet nga zhvlerësimi që kanë ndodhur në portofolin e mirë por që nuk janë identifikuar. Sipas SNRF 9, zhvlerësimi i aktiveve financiare që nuk konsiderohen se kanë pësuar një rritje të konsiderueshme në rrezikun e tyre të kredisë do të matet në bazë të ECL-së 12-mujore. Në krahasim me periudhat e shfaqjes prej 3, 6 dhe 12 muajsh sipas SNK 39, shuma e provigjonit 12 mujor sipas ECL-së pritet të jetë më e lartë se provigjoni aktual IBNI. Bazuar në analizën e kryer, provigjoni 12-mujor ECL i llogarit në portofolin 2017 do të ishte më i lartë se provigjoni IBNI sipas SNK 39.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Klasa 2

SNRF 9 kërkon që aktivet financiare të klasifikohen në Klasën 2 kur rreziku i tyre i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare. Për këto aktive, një humbje në provigjon duhet të njihet bazuar në ECL-të e tyre të matura përgjatë gjithë jetës. Duke qenë se ky është një koncept i ri në krahasim me SNK 39, ai do të rezultojë në rritje të provigjonit pasi shumica e aktiveve të tilla nuk konsiderohen të jenë kreditë të provigjonuara sipas SNK 39. Nëse standardi i ri do të zbatohet në vitin 2017, kjo do të rezultonte në një rritje të fondit të provigjonit.

Banka shqyrton nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë të një aktivi duke krahasuar probabilitetin përgjatë gjithë jetës të përkeqësimit pas njohjes fillestare të aktivit kundrejt rrezikut të përkeqësimit që ndodh në aktiv në fund të çdo periudhe raportuese. Në secilin rast, ky vlerësim bazohet në një vlerësim të ardhshëm që merr parasysh një numër skenarësh ekonomikë, në mënyrë që të njihë probabilitetin e humbjeve më të larta që lidhen me parashikime ekonomike më shumë negative. Për më tepër, supozohet një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë në qoftë se huamarrësi vonohet më shumë se 30 ditë për të bërë pagesat e tij kontraktuale, ose nëse banka pret t'i kryejë ristrukturim huamarrësit (forbearance), ose aktivi vendoset në listën në ndejkje të bankës. Është politika e Bankës të vlerësojë informacione parashikuese shtesë në dispozicion, të cilat janë arsyeshme dhe mbështetëse, si një drejtim i shtuar. Gjatë vlerësimit të ECL-ve të matura përgjatë gjithë jetës për angazhimet e padisbursuara të huave, Banka do të:

- Vlerësojë pjesën e pritur të angazhimit të huasë që nuk do të disbursohet përgjatë jetës së pritur të angazhimit të huasë dhe
- Llogarisë vlerën aktuale të humbjeve të monetare midis flukseve monetare kontraktuale që i takojnë njësisë ekonomike nëse zotëruesi i angazhimit të huasë zvogëlon atë pjesë të pritshme të kredisë dhe flukseve të mjeteve monetare që Banka pret të marrë nëse ajo pjesë e pritshme e kredisë është tërhequr.

Për kontratat e garancisë financiare, Banka do të vlerësojë ECL-të e matur përgjatë gjithë jetës bazuar në vlerën aktuale të pagesave për rimbursim të pritshme kundrejt mbajtësin për një humbje të pritshme të kredisë, pakësuar me çdo shumë që garantuesi parashikon të arkëtojë nga mbajtësi, debitori ose ndonjë tjetër palë. Nëse një hua është e garantuar plotësisht, vlerësimi i ECL-së për kontratën e garancisë financiare do të ishte i njëjtë me vlerësimin e parashikuar të moskryerjes së pagesave me vlerësimin e huasë subjekt i garancisë.

Për kredi qarkulluese siç janë kartat e kreditit dhe overdraftet, Banka mat ECL-të duke përcaktuar periudhën gjatë së cilës pret të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të rrezikut të kredisë që ajo pret të ndërmarrë pasi të jetë rritur rreziku i kredisë që do të shërbejë për të zbutur humbjet.

Banka synon të zbatojë një politikë që nëse transferimi në Klasën 2 është shkaktuar fillimisht nga tregues të ndryshëm nga luhatja në probabilitetin e dështimit, kredia mund të kthehet vetëm në Klasën 1 nëse kriteri për klasifikimin në Klasën 2 hiqet.

Klasa 3

Aktivitet financiare do të përfshihen në Klasën 3 kur ka prova objektive që huaja është një kredi e përkeqësuar. Kriteret e provave të tilla objektive janë të njëjta sikurse sipas metodologjisë aktuale të SNK 39. Prandaj, Banka pret që popullata të jetë përgjithësisht e njëjtë nën të dyja standardet.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Klasa 3(vazhdim)

Kreditë në Klasën 3, ku Banka ka llogaritur zhvlerësimin IAS 39 në baza individuale, do të vazhdojë të llogaritet në të njëjtën bazë, por vlerat e kolateralit do të rregullohen për të pasqyruar shumat që mund të pritet të realizohen, duke i kushtuar vëmendje mundësisë se këto do të jenë më të ulta në skenarë makroekonomikë më të pafavorshëm.

Pritet që kreditë në Klasën 3 të jenë të njëjta me ato që konsiderohen të zhvlerësuara në përputhje me SNK 39. Llogaritja e zhvlerësimit do të jetë e njëjtë me atë të kredive të Klasës 2 me probabilitetin e dështimit të vendosur në 100%. Kur restrukturimi rezulton në çregjistrimin e kredisë origjinale, kredia e re do të klasifikohet si kredi e keqe që në çelje. Kreditë e tjera, të ndryshme nga kreditë e çelura si kredi të këqija, do të transferohen jashtë Klasës 3 nëse ato nuk plotësojnë më kriteret e përkeqësimit të kredisë pas një periudhe prove një vjeçare.

Informacion i arsyeshme dhe i mbështetur

Banka do të inkorporojë informacionin parashikues si në vlerësimin e rritjes së ndjeshme të rrezikut të kredisë ashtu edhe në matjen e ECL-ve.

Banka e konsideron informacionin parashikues siç janë faktorët makroekonomikë (p.sh., për rritjen e PBB-së jo me pakicë, rritja e PBB-së të vendit, inflacioni dhe normat e interesit) dhe parashikimet ekonomike. Një parim i rëndësishëm që përdoret në kuadrin e parashikimit të SNRF 9 është përputhja me kuadrin e Buxhetit të Bankës. Më specifikisht:

- SNRF9 do të bazohet në skenarët dhe variablat ekonomike të parashikuara nga ekonomistët e Bankës. Këto variabla vërehen përmes vrojtimeve të shkuara, parashikimeve dhe përditësimit të tyre që do të përgatiten për entitetet e grupit (IBFS) nga ekspertë të brendshëm ekonomikë, me frekuencë tremujore.
- Në kohën e përgatitjes së buxhetit, supozimet e SNRF 9 duhet të jenë në përputhje me Koston e Rrezikut të buxhetuar për vitet e ardhshme.

Banka do të nxjerrë një ECL në bazë të pamjes "të paanshme" (jo të theksuar) të parashikimeve; skenari bazë paraqet rezultatin më të mundshëm që rezulton nga procesi normal i planifikimit financiar dhe buxhetimit të bankës.

Banka do të përdorë informacionin e brendshëm që vjen nga ekspertë ekonomik të brendshëm, të kombinuara me informacione të jashtme të publikuara nga shërbimet e parashikimit qeveritar dhe privat. Një Komision Ekspertësh, duke përfshirë edhe menaxherët e Riskut, Financës dhe Biznesit, do të duhet të miratojë supozimet e parashikimeve para se ato të aplikohen.

Kufizimi i teknikave të vlerësimit

Modelet e aplikuara nga Banka mund të mos kapin të gjithë karakteristikat e tregut në një moment në kohë, pasi ato nuk mund të ri-kalibrohen në të njëjtin ritëm si ndryshimet në kushtet e tregut. Rregullimet e përkohshme priten të nevojiten të bëhen derisa modelet bazë të përditësohen dhe miratohen nga Bordi Mbikëqyrës i Bankës, prandaj çdo vlerësi ndikimi i përkohshëm nuk konsiderohet përfundimtar dhe nuk do të zbulohet. Megjithatë Banka do të përdorë të dhëna sa më aktuale të jetë e mundur, modelet e përdorura për llogaritjen e ECL-ve do të bazohen në të dhëna që janë tre muaj në vonesë dhe do të bëhen rregullime për ngjarje të rëndësishme që ndodhin para datës së raportimit. Qeverisja mbi rregullimet e tilla është ende në zhvillim.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Menaxhimi i kapitalit

Banka është në proces të vlerësimit se si modeli i ri i ECL-së do të ndikojë në strukturën e vazhdueshme të kapitalit rregullator të Bankës, dhe detaje të mëtejshme do të sigurohen pasi vlerësimi të jetë i plotë. Bazuar në analizën e deritanishme, Banka parashikon një efekt negativ në kapitalin e saj rregullator. Madhësia e efektit do të varet, ndër të tjera, nëse rregullat e kapitalit do të ndryshohen për të pasqyruar SNRF 9 ose për të përfshirë provigjonet e ndryshimit për efektin e SNRF 9.

Menaxhimi i vazhdueshëm i rrezikut, struktura e operimive dhe e financës

Banka do të paraqesë modelin e propozuar të veprimit në Bordin Mbikëqyrës në tetor 2018 dhe detaje të mëtejshme do të paraqiten sapo të jetë miratuar struktura e re operative.

SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 është publikuar në maj 2014 dhe përcakton një model pesë-hapësh për të llogaritur të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientët. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një shumë që pasqyron vlerësimin për të cilin Banka pret t'i njoh në këmbim për transferimin e mallrave ose shërbimeve një klienti.

Standardi i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale për njohjen e të ardhurave sipas SNRF-ve. Ose një aplikim i plotë retrospektiv ose një aplikim retrospektiv i modifikuar është i nevojshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 kur BSNK përfundon ndryshimet e tyre për të shtyrë datën efektive të SNRF 15 për një vit. Aplikimi i hershëm është i lejuar. Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rrjedhin nga SNRF 15.

Interpretimi i KIRFN 22 Transaksionet në valutë të huaj dhe Konsiderata paraprake

Transaksionet në valutë të huaj dhe Konsiderata paraprake janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Banka do të zbatojë ndryshimet kur ato hyjnë në fuqi.

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat

Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Banka do të zbatojë ndryshimet kur ato hyjnë në fuqi.

SNRF 2 Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione - Ndryshimet në SNRF 2

Ndryshimet në klasifikimin dhe matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me lejen e aplikimit të hershëm. Nuk aplikohet për Bankën.

Transferet e Pronave të Investimit - Ndryshimet në SNK 40

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Aplikimi i hershëm i ndryshimeve lejohet dhe duhet të jepet informacion shpjegues. Banka do të zbatojë amendimet kur të hyjnë në fuqi.

Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqatës së tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 në trajtimin e humbjes së kontrollit të një filiali që shitet ose kontribuohet në një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët. BSNK ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një njësi ekonomike që në fillim i miraton ndryshimet, duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive. Nuk është i aplikueshëm për Bankën.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të kërkuara. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që njësi ekonomike të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së zbatimit të parë të SNRF 17. Nuk është i aplikueshëm për Bankën.

Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - Ndryshime në SNRF 4

Ndryshimet adresojnë shqetësimet që dalin nga zbatimi i standardit të ri të instrumenteve financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve, i cili zëvendëson SNRF 4. Përfundimi i përkohshëm aplikohet për herë të parë për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Nuk është i aplikueshëm për Bankën.

3. Politika të rëndësishme kontabël

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç investimeve të vlefshme për shitje, të cilat maten me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të veçanta paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës.

(d) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit për aktivet monetare, është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit.

(e) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse në bazë të metodës së interesit efektiv.

Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe rishikohet në çdo datë riqimimi.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, emetimin ose fshirjen e një aktivi apo detyrimi financiar.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Tarifat e angazhimet të kredisë për kredi që ka të ngjarë të zvogëlohen dhe pagesa të tjera të lidhura kredinë shtyhen (së bashku me çdo kosto rritëse) dhe njihen si një rregullim të normës efektive të interesit të kredisë.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(g) Qiraja

Banka si qiramarrëse - Pagesat operative të qirasë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është një kontratë qiraje ose përmban një kontratë qiraje, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi të caktuar ose aktiveve dhe marrëveshja përcjell të drejtën për të përdorur aktivin. Qiratë, që në thelb, nuk transferojnë në Bankë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e sendeve të dhëna me qira janë qiratë operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera përmbledhëse në baza lineare gjatë periudhës së qirasë. Incentivat e qerasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

Banka si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Banka transferon kryesisht të gjithë rrezikun dhe përfitimet nga pronësia e aktivit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e pozicionit financiar Banka paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën e investimit neto. Njohja e të ardhurave financiare duhet të bazohet në një model që pasqyron një normë periodike konstante të kthimit të investimit neto të qiradhënësit në qiranë financiare. Pagesat e qirasë në lidhje me periudhën, duke përjashtuar kostot për shërbime, zbatohen kundrejt investimit bruto në qira, për të reduktuar si principalin ashtu edhe të ardhurat financiare të paarkëtuara.

Të ardhurat e shitjeve të njohura në fillimin e afatit të qirasë nga një prodhues ose qiradhënësi me qira janë vlera e drejtë e aktivitetit ose, nëse është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë që rrjedhin nga qiradhënësi, të llogaritura me një normë tregu të interesit.

(h) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

(i) Planet e pensione me përfitim të përcaktuar

Kontributet e Bankës ndaj planit të pensione me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione.

(j) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

ato kthehen mbrapsht bazuar në ligjet që janë në forcë në datën e raportimit. Detyrim tatimor i shtyrë njihet për të gjithë diferencat e përkohshme të tatueshme.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Tatim fitimi (vazhdim)

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e pozicionit financiar, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar, dhe bazës së tyre tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme të mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet. Tatime të tjera mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendët përkatës.

(k) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka njihet huatë, parapagimet dhe depozitat me kosto në datën kur i lind e drejta e detyrimit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare të tjera njihen në datën e tregëtimit, datë në të cilën Banka bëhet palë e kontratës.

(ii) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Bankës ndaj rrjedhjeve monetare që vijnë nga aktiviteti financiar mbarojnë ose nëse Banka i transferon aktivitetin financiar një pale tjetër bashkë me kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Çdo interes në aktive financiare të transferueshme që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare çregjistrohen nga Banka nëse detyrimet kontraktuale të Bankës mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivitetet i shiten një pale të tretë, dhe Banka përfshihet në një transaksion shkëmbyes për të njëjtin aktiv me një normë kthimi përafërsisht të njëjtë, transaksioni regjistrohet si një transaksion financiar i ngjashëm me transaksionet e riblerjeve. Në transaksione në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetet financiare, Banka e çregjistron aktivitetin nëse e humbet kontrollin mbi aktivitetin.

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Banka vazhdon ta njohë aktivitetin deri në momentin e përfshirjes së saj të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

Gjithashtu Banka i çregjistron disa aktive kur këto balanca gjykohen të parikuperueshme (shiko shënim 4).

(iii) Prezantimi me bazë neto

Banka nuk neton aktive dhe detyrime ose të ardhura dhe shpenzime, përveçse nëse kërkohet ose lejohet nga SNRF. Gjithashtu, Banka paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i ngjashëm transaksionesh, për shembull, fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore. Megjithatë, Banka mund t'i paraqesë të tilla fitime ose humbje në mënyrë individuale në qoftë se ato janë materiale.

(iv) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktiviteti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktiviteti ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Matja e vlerës së drejtë

Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregëtueshme në tregje aktive. Për të gjithë instrumentet e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Për të përcaktuar vlerën e drejtë, Banka përdor hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura për llogaritjet:

Niveli 1: Çmimi i kuotuar në treg (i pa rregulluar), në një treg aktiv për një instrument të njëjtë.

Niveli 2: Metodatat e vlerësimit të bazuar në të dhënat e vëzhgueshme direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet).

Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotura në tregje aktive për instrumente të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose metoda të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: Metodatat e vlerësimit që përdorin të dhëna të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimit përfshijnë të dhëna të rëndësishme të cilat nuk mund të vëzhgohen, dhe këto të dhëna kanë efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumenteve. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmimin e kuotuar të instrumenteve të ngjashëm, çmim i rregulluar bazuar në të dhëna të pavëzhgueshme ose supozime të tjera për të reflektuar diferencat ndërmjet instrumenteve që vlerësohen dhe instrumenteve të kuotuar.

Banka përdor metoda të njohura në fushën e vlerësimit, për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumenteve financiar. Për këto instrumente financiare, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg. Metodatat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto, modelin e skontuar të flukseve të parasë ose krahasimin me instrumenta të ngjashëm për të cilët ekziston çmimi i vëzhgueshëm në treg bazuar në normën e interesit aktual për afatin e mbetur deri në maturim. Objektivi i teknikave të vlerësimit është që të arrijnë të përcaktojnë një vlerë të drejtë që pasqyron çmimin e instrumenteve financiare në datën e raportimit, e cila do të ishte përcaktuar nga pjesmarrësit e tregut që veprojnë si transaksione normale.

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ekzistojnë evidenca objektive që një ngjarje që sjell humbje, ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Banka i zhvlerëson aktivet e saj individualisht dhe gjithashtu në grup. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme analizohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Të gjitha aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme analizohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë, mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje, të dhëna që një huamarrës ose një emetues borxhi po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh. ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi ose huadhënësi në Bankë ose kushtet ekonomike që mund të sjellin vonesa në pagesa ndaj Bankës.

Për përcaktimin e zhvlerësimit në grup, Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rekuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rekuperimit krahasohen përkundërt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuara llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje pasqyrohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse.

(l) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve afatshkurtra.

(m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht njihen me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Letrat me vlerë

Investimet në letra me vlerë maten me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohen sipas klasifikimit si të mbajtura deri në maturim ose të mbajtura për shitje.

(i) Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim janë aktive që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka për qëllim t'i mbajë deri në maturim të cilat nuk mbahen në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose nuk klasifikohen si të vlefshme për shitje. Ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim me vlerë të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

(ii) Letrat me vlerë të mbajtura për shitje

Investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare.

Investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse sipas metodës së interesit efektiv. Të ardhurat / humbjet nga këmbimet valutore të letrave me vlerë të mbajtura për shitje regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithpërfshirëse.

Fitimet apo humbjet nga një aktiv financiar i vlefshëm për shitje njihen tek pasqyra e të ardhurave përmbledhëse, përveç humbjeve nga zhvlerësimi dhe fitimeve dhe humbjeve nga kurset e këmbimit derisa aktiv i financiar çregjistrohet. Fitimet dhe humbjet e mbartura deri në momentin e ç' regjistrimit në të ardhurat përmbledhëse, riklasifikohet nga kapitali në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Gjithsesi, interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet Jo të Vijueshme

Aktivitet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje maten me vlerën më të ulët mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Një njësi ekonomike klasifikon një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje nëse vlera e tij kontabël (neto) do të rifitohet parimisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje në vend të përdorimit të vazhdueshëm. Nëse ky është rasti, aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) duhet të jetë i përshtatshëm për shitje të menjëhershme në kushtet e tij aktuale subjekt vetëm për kushtet që janë të përdorshme dhe të zakonshme për shitjet e aktiveve të tilla (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) dhe shitja e tij duhet të jetë me probabiliteti të lartë për t'u realizuar brenda një viti.

(p) Aktivet e marra nëpërmjet një procesi gjyqësor

Politika e Bankës është të përcaktojë nëse një aktiv i blerë nëpërmjet gjykimit është përdorur më së miri për operacionet e saj të brendshme ose duhet të shitet. Aktivitet e përcaktuara për të qenë të dobishme për operacionet e brendshme të Bankës transferohen në kategorinë e tyre përkatëse të aseteve me vlerën më të ulët të vlerës së tyre të riposeduar ose vlerën kontabël të aktivitet të siguar të origjinës. Më 31 dhjetor 2017 nuk ka asete të tilla.

Banka mban pjesën tjetër të pasurisë së fituar nëpërmjet procesit gjyqësor, dmth. zbatimin e kolateralit mbi huatë dhe paradhëniet si inventar. Banka mat këto aktive fillimisht me koston e tyre (çmimin e blerjes). Në fund të çdo periudhe raportuese, këto aktive maten me vlerën më të ulët të vlerës kontabël neto ose me vlerën neto të realizueshme. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën neto të realizueshme të këtyre aktiveve janë përfshirë në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato paraqiten, si zhvlerësime të inventarit. Këto asete janë çregjistruar me rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit ose kur nuk ka përfitime ekonomike të ardhshme që priten nga nxjerrja jashtë përdorimit. Çdo fitim ose humbje që vjen si rezultat i çregjistrimit së këtyre aktiveve (llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto të nxjerra nga përdorimi dhe vlerës kontabël të aktivitet) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

(q) Aktivet e trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse në momentin kur ndodhin.

(ii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse me anën e metodës lineare gjatë jetës së çdo pjesë të një aktivi të trupëzuar. Përmirësimet e bëra në aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitet.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	<u>(në vite)</u>
Ndërtesa	30
Kompjutera dhe pajisje informatike	5
Instalime dhe pajisje të tjera	5
Pajisje zyre	10
Automjete	5
Investime në mjetet e marra me qira	5

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Zhvlerësimi nuk llogaritet për aktivet në proçes.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(s) Aktivitet e patrupëzuara

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të fitimit ose humbjes, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është dhjetë vjet.

(t) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të mjeteve monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

(u) Depozita dhe detyrime të tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për riblerje në një datë të caktuar të ardhshme nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar pasi Banka ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Paraja përkatëse e pranuar njihet në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv me një detyrim korrespondues për ta kthyer atë, duke përfshirë interesin e përlllogaritur si një pasiv brenda kolateralit të parasë së gatshme në letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e riblerjes duke pasqyruar thelbin ekonomik të transaksionit si një hua për Bankën. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe është përlllogaritur gjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur normën e interesit efektiv.

Banka klasifikon instrumentet e borxhit si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(v) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një nxjerrje fondesh do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi.

Provizionet caktohen duke skontuar rrjedhjet e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme rrezikun specifik të detyrimit.

(w) Paraqitja e vlerës së drejtë

Hua dhe paradhënie ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Huatë dhe paradhëniet dhënë bankave dhe institucioneve financiare përfshijnë vendosjet ndërbankare. Vlera e tyre e drejtë konsiderohet të përafrojë vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose normave bazë të interesit, të cilat i përafrojnë normat e tregut.

Hua dhe paradhënie për klientët

Huatë dhe paradhëniet paraqiten neto me fondin e provizionimit. Portofoli i huave të bankës ka një vlerë të drejtë të përafërt me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së luhatshme të normave të interesit, me huatë që riçmohen brenda cilit një-vjeçar, me përjashtimin e një grupi kredie të dhënë në vitin 2008, i cili është dhënë pa një çmim dysHEME të aplikueshëm.

Kontratat e qirasë financiare

Kontratat e qirasë financiare kanë një vlerë të drejtë që është e përafërt me vlerën e tyre kontabël. Tenori mesatar i këtyre kontratave është pothuajse afat-mesëm ose afër maturitetit dhe mbart normë të luhatshme të interesit, e cila çmohet brenda një cikli njëvjeçar.

Detyrime të tjera ndaj bankave dhe klientëve

Vlera e drejtë e depozitave me afat përafrohet me vlerën kontabël për shkak të natyrës së tyre të maturimit afatshkurtër, me përqëndrimin e depozitave duke qene brenda grupit (0:1 viti).

Tabela ne vijim përmbledh vlerën e drejtë të instrumentave financiare sipas klasifikimit të tyre në pasqyren e pozicionit financiar:

Aktivet dhe Detyrimet financiare	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë
Aktivet financiare				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3,774,418	3,774,418	7,104,355	7,104,355
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	6,349,420	6,349,420	5,986,772	5,986,772
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,368,578	1,368,578	1,313,232	1,313,232
Aktive të mbajtura për shitje	87,424	87,424	104,314	126,170
Aktive të tjera	196,700	196,700	287,510	287,510
Investime të vlefshme për shitje	20,128,090	20,128,090	19,622,279	19,622,279
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	47,519,086	48,128,408	44,761,531	45,203,481
Qiratë financiare	1,029,878	1,029,878	688,226	688,226
Totali i aktiveve financiare	80,453,594	81,062,916	79,868,219	80,332,025
Detyrimet financiare				
Detyrime ndaj institucioneve financiare	3,623,800	3,623,800	7,629,534	7,629,534
Detyrime ndaj klientëve	68,196,427	68,176,200	64,199,730	63,978,122
Detyrime nga aktivet e mbajtura për shitje	26,458	26,458	25,221	25,221
Detyrime të tjera	267,159	267,159	145,359	145,359
Totali i detyrimeve financiare	72,113,844	72,093,617	71,999,844	71,778,236

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)***3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****(w) Paraqitja e vlerës së drejtë (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 të gjithë instrumentat financiarë janë matur me kosto të amortizuara, me përjashtim të investimeve në letra me vlerë të mbajtura për shitje dhe aktiveve të mbajtura për shitje të cilat janë matur me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 për investimet në letrat me vlerë mbajtur për shitje është matur bazuar në nivelin 2 të hierarkisë. Për aktivet e marra në rrugë ligjore vlera e drejtë është matur bazuar në nivelin 3 të hierarkisë.

	31 dhjetor 2017					31 dhjetor 2016				
	Vlera e mbartur	Kosto e amortizuar	Vlera e drejtë			Vlera e mbartur	Kosto e amortizuar	Vlera e drejtë		
			Nivel 1	Nivel 2	Nivel 3			Level 1	Level 2	Level 3
Aktive										
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3,774,418	3,774,418	-	-	-	7,104,355	7,104,355	-	-	-
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	6,349,420	6,349,420	-	-	-	5,986,772	5,986,772	-	-	-
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	1,368,578	1,368,578	-	-	-	1,313,232	1,313,232	-	-	-
Aktive të mbajtura për shitje	87,424	-	-	87,424	-	104,314	-	126,170	-	-
Aktive të tjera	235,672	235,672	-	-	-	319,258	319,258	-	-	-
Investime të vlefshme për shitje	20,128,090	-	-	20,128,090	-	19,622,279	-	19,622,279	-	-
Hua dhe paradhënie për klientët	47,519,086	-	-	-	48,128,408	44,761,531	-	-	-	45,203,481
Qiratë financiare	1,029,878	1,029,878	-	-	-	688,226	688,226	-	-	-
Totali i aktiveve	80,492,566	12,757,966	-	20,215,514	48,128,408	79,899,967	15,411,843	-	19,748,448	45,203,481
Detyrime										
Kredi dhe paradhënie nga institucionet financiare	3,623,800	3,623,800	-	-	-	7,629,534	7,629,534	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	68,196,427	-	-	-	68,176,200	64,199,730	-	-	-	63,978,122
Detyrime të tjera	596,296	596,296	-	-	-	487,988	487,988	-	-	-
Detyrime lidhur me aktivet për tu shitur	26,458	26,458	-	-	-	25,221	25,221	-	-	-
Totali detyrimeve	72,442,981	4,246,554	-	-	68,176,200	72,342,473	8,142,743	-	-	63,978,122

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi i Bankës ka diskutuar me Bordin Drejtues zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Bankës dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet që lidhen me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar në qoftë se rishikimi prek vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon njëkohësisht në periudhën raportuese dhe në periudhat e ardhshme. Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shiko shënimin 32).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Zhvlerësimet për humbje nga kreditë

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimeve të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë nga Drejtimi të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar vlerësohet bazuar mbi cilësitë e tij dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavaruar nga Departamenti i Riskut.

Fondi i zhvlerësimit për kreditë në grup mbulon humbjet nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv drejtimi konsideron faktorë si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimin si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar janë bërë supozime për të përcaktuar sesi janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të provizionit varet nga sa të matshme janë rrjedhjet e ardhshme të projektuara dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose për të paguar transferimin e një pasivi në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (p.sh. një çmim dalës) pavarësisht nëse ky çmim është direkt i vëzhgueshëm ose i vlerësuar duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi. Kur vlerat e drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të rrjedhin nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një sërë teknikash vlerësimi që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet e këtyre modeleve merren nga tregjet të vëzhgueshme aty ku është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, kërkohet vlerësimi në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsideratat e likuiditetit dhe inputeve të modeleve që lidhen me zërat si rreziku i kredisë (si vete dhe pala tjetër), normat e fundit të interesit nga tregu, korrelacioni dhe paqëndrueshmëria. Për detaje të mëtejshme në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë, shih Shënimin 3.w.

Zvogëlimi në vlerë i investimeve të vlefshme për shitje

Banka shqyrton letrat me vlerë të borxhit të klasifikuara si investime të vlefshme për shitje në çdo periudhë raportuese për të vlerësuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Kjo kërkon një gjykim të ngjashëm siç zbatohet për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.

Banka gjithashtu regjistron zërat e zhvlerësimit të investimeve të vlefshme për shitje, kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e tyre. Përcaktimi i asaj që është 'domethënës' ose 'i zgjatur' kërkon gjykimin. Për të bërë këtë gjykim, Banka vlerëson, ndër faktorët e tjerë, lëvizjet historike të çmimeve të aksionit dhe kohëzgjatjen dhe shkallën në të cilën vlera e drejtë e një investimi është më e vogël se kostoja e saj.

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

5. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të detajuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Arka		
Në Lek	749,897	764,677
Në monedhë të huaj	556,520	514,463
Llogari rrjedhëse me Bankën Qëndrore	28,079	232,596
Llogari rrjedhëse me bankat e tjera	1,894,075	4,756,699
Vendosjet në tregun e parasë	545,847	835,920
Totali	3,774,418	7,104,355

Norma e interesit vjetor për depozitat me afat me bankat rezidente gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 variojnë nga 0.25% në 1.80% (2016: 0.25% në 1.80%) dhe për depozitat me afat me bankat jo-rezidente nga 0.05% në 0.75% (2016: 0.05% në 0.75%).

Llogaritë rrjedhëse me bankat në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të detajuara gjeografikisht si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Austri	164,668	679,343
Francë	1,592,904	3,933,585
Shqipëri	208	158
Zvicër	69,068	12,476
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	38,486	118,559
Britani e Madhe	28,741	12,578
Totali	1,894,075	4,756,699

Vendosjet në tregun e parasë në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 të detajuara gjeografikisht janë si më poshtë dhe maturiteti i tyre varion nga 5-8 ditë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shqipëri	-	450,033
Francë	110,976	385,887
Austri	434,871	-
Totali	545,847	835,920

6. Shumat e kushtëzuara me Bankën Qëndrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qëndrore lidhur me depozitën rezervë, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve pranë Bankës Qëndrore si llogari rezervë. Më 31 dhjetor 2017, Banka ka rezervë statusore shumë prej Lek 6,349,420 mijë (2016: Lek 5,986,772 mijë)

Interesat mbi rezervën e detyrueshme në Bankën Qëndrore janë llogaritur si më poshtë:

- LEK: 70% mbi normat e marrëveshjeve të riblerjes: 1.25% në vit për 31 dhjetor 2017 (31 dhjetor 2016: 1.25% në vit);
- USD: 0.00% në 31 dhjetor 2017 (31 dhjetor 2016: 0.00% në vit);
- Euro: -0.04% në 31 dhjetor 2017 (31 dhjetor 2016: -0.04% në vit).

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)***7. Hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare**

Huatë dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Rezidentë		
Hua ndaj institucioneve financiare	1,357,468	1,300,415
Jo rezidentë	-	-
Llogari escrow për garanci bankare	11,110	12,817
Totali	1,368,578	1,313,232

8. Investime të vlefshme për shitje

Investimet e vlefshme për shitje në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Bono thesari (8.1)	-	-
Obligacione qeveritare (8.2)	20,128,090	19,622,279
Totali	20,128,090	19,622,279

8.1 Bono thesari

Më 31 dhjetor 2017 Banka nuk ka ekspozim në Bono e thesari (2016: nuk ka ekspozim).

8.2 Obligacione qeveritare

Obligacionet qeveritare janë të detajuara si më poshtë sipas maturitetit:

	31 dhjetor 2017				
	Vlera Nominale	Prim / (Skonto)	Interes i përlllogaritur	Diferencë rivlerësimi	Vlera e mbartur
Maturitet					
24 muaj	1,040,000	-	9,954	(1,190)	1,048,764
36 muaj	680,000	-	7,371	(2,629)	684,742
60 muaj	7,310,000	32,633	84,547	(4,532)	7,422,648
84 muaj	3,690,000	41,785	60,943	(48,880)	3,743,848
120 muaj	1,680,000	1,120	60,146	244,336	1,985,601
Euro Bond	2,526,050	(7,643)	19,366	275,460	2,813,233
24 muaj në Euro	2,422,881	-	6,373	-	2,429,254
	19,348,931	67,894	248,700	462,565	20,128,090

	31 dhjetor 2016				
	Vlera Nominale	Prim / (Skonto)	Interes i përlllogaritur	Diferencë rivlerësimi	Vlera e mbartur
Maturitet					
24 muaj	2,740,000	-	29,014	(5,598)	2,763,416
36 muaj	1,250,000	122	23,562	13,820	1,287,504
60 muaj	6,360,000	8,188	76,508	28,423	6,473,119
84 muaj	2,690,000	58,580	42,818	(25,182)	2,766,216
120 muaj	1,680,000	1,312	60,883	256,973	1,999,168
Euro Bond	2,569,370	(10,485)	19,833	224,359	2,803,078
24 muaj në Euro	1,517,822	126	11,831	-	1,529,778
	18,807,192	57,843	264,448	492,795	19,622,279

BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat janë shprehur në mijë Lek, përvec kur është shprehur ndryshe)

8. Investime të vlefshme për shitje (vazhdim)

8.2 Obligacione qeveritare (vazhdim)

Obligacionet qeveritare përfitojnë interes gjashtë mujor me një normë kuponi më 31 dhjetor 2017 ndërmjet 0.75% deri në 9.25% (31 dhjetor 2016: nga 0.75% deri në 9.53%). Gjatë 2017, Banka investoi në blerjen e një Eurobond-i, prej 14,500 mijë Euro me një normë vjetore 0.80%. Një pjesë e investimit prej EUR 7,500 është maturuar në 20 gusht 2017. Në dhjetor 2016, Banka morri pjesë në emetimin e Eurobondit prej EUR 3,724 mijë me një normë vjetore interesi prej 0,75%. Më 31 dhjetor 2017, një shumë prej 1,658,500 mijë Lek (2016: 4,670,000 mijë Lek) është lënë si kolateral për marrëveshjet e riblerjes të paraqitur në shënimin 15.

8.3 Lëvizjet në investime të vlefshme për shitje

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në balancat e investimeve të vlefshme për shitje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, duke përfshirë blerjet dhe maturimet përgjate këtyre viteve:

	Lëvizjet në investime të vlefshme për shitje	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Balanca në fillim	19,622,279	19,995,349
